

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P. “RISAMONT” & “LISI GROUP” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë
Nga:	Jetulla Kabashi – Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Lënda:	VENDIM i Kërkesën për rishqyrtim të datës: 03/09/2018
Datë:	05/09/2018

I nderuar z. Ilaz Islami – Drejtor,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të datës: 03.09.2018, të pranuar formë elektronike përmesë [e-prokurimit](mailto:prokurimi.rahovec@gmail.com) dhe e-mail adrese: prokurimi.rahovec@gmail.com, nga Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P. “RISAMONT” & “LISI GROUP” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-18-4613-5-2-1**, Nr i brendshëm: **623-18-036-5-2-1**, inciuar nga Autoriteti Kontraktues: (AK) – **Komuna e Rahovecit**.

Kërkesa është **REFUZUAR** si e pa bazë konform nenit 108/A pika 8.4 të LPP-së, sepse asnjë nga këto nenet nuk janë shkelur.

- Arësyetim:

Pas kërkesës tuaj dhe pretendimeve se janë shkelur nenet:

Neni 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 52 – Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës,

Neni 56 – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,

Neni 60 – Kriteri për Dhënien e Kontratës,

Neni 61 – Tenderët Jo-normalisht të Ulët respektivisht Rregullat B57.

Ne si A.K. – Komuna e Rahovecit ju kemi derguar formularin: **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku ju kemi cekur se Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Neni 61 – Tenderët Jo-Normalisht të Ulët:

Paragrafi 4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

Të gjitha pozicionet në paramas të cilat e keni dhënë me çmim: 0.1 €, çmimi i furnizimit (blerjes) për sasin e kërkuar në paramas kap shumën: 42,772.05 €, që na keni dhënë ju në arsyetim tuaj si çmim i blerjes.

Për të gjitha këto sasi që do të na shitni neve si Autoritet Kontraktues çmimi i dhënë nga ju: 312.40 €.

Andaj tenderi juaj refuzohet si abnormalisht i ulët, sipas LPP – së dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

-Kundër këtij **vendimi të AK ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së.

Me respekt

Jetulla Kabashi

Shef i Zyres së Prokurimit – Komuna e Rahovecit.
